

1. Çfarë është AIC?

Albanian Investment Corporation (AIC) është krahu investues i qeverisë shqiptare, i krijuar për të zhvilluar dhe menaxhuar asetet publike me qëllim nxitjen e zhvillimit ekonomik të qëndrueshëm. AIC ka marrë autorizimin për të zhvilluar projekte të rëndësishme infrastrukturore dhe teknologjike, duke përfshirë **Durana Tech Park**, me qëllim tërheqjen e investimeve të huaja dhe vendase në sektorët e teknologjisë, inovacionit dhe industrive të lidhura.

2. Kuadri Ligjor i Durana Tech Park

Durana Tech Park funksionon brenda një kuadri të fortë ligjor dhe fiskal që ofron stimuj të rëndësishëm për investitorët. Ky kuadër rregullohet nga një sërë vendimesh të Këshillit të Ministrave dhe akteve ligjore që synojnë të krijojnë një mjedis tërheqës për inovacionin dhe zhvillimin teknologjik në Shqipëri.

1. **Ligji Nr. 58/2022** për krijimin e parqeve teknologjike dhe shkencore është baza ligjore e parkut, e cila përcakton procedurat për krijimin dhe funksionimin e parqeve teknologjike në vend.
2. **VKM Nr. 337, datë 31/05/2023** për “Procedurat dhe kriteret për përzgjedhjen e zhvilluesve të parqeve shkencore dhe teknologjike”, përshkruan kriteret që duhet të përmbushen për të përfituar nga statusi i zhvilluesit të një parku teknologjik.
3. **VKM Nr. 185, datë 27/03/2024** specifikon miratimin e AIC si zhvillues i Durana Tech Park dhe parashtron paketën e lehtësirave fiskale për investitorët që operojnë në park.
4. **VKM Nr. 416 dhe aktet e tjera për incentivave fiskale:**

3. Incentivat Fiskale për Investitorët

Durana Tech Park ofron një sërë lehtësirash fiskale për kompanitë që zgjedhin të vendosen në park, përfshirë:

- **0% Tatim mbi Fitimin** për një periudhë 15-vjeçare për të ardhurat që gjenerohen nga veprimtaritë të cilat zhvillohen në park.
- **Përrjashtime nga TVSH-ja** për mallrat dhe shërbimet e përdorura për qëllime kërkimi dhe zhvillimi (R&D).
- **Përrjashtime nga taksat doganore** për importet e pajisjeve teknologjike dhe inovative.
- **Lehtësime në Sigurimet Shoqërore**, ku kontributet mund të paguhen mbi bazën e pagës minimale për një periudhë të caktuar.
- Përrjashtim nga të gjitha taksat për një periudhë 10-vjeçare për pagat e personelit që punon në kërkim-zhvillim në park.
- Përrjashtim nga taksa e ndikimit në infrastrukturë dhe taksa e pasurisë së paluajtshme për një periudhë 10-vjeçare për ndërtimet e realizuara në park.
- Rimbursim i pjesshëm nga shteti për kostot e trajnimit për punonjësit shkencorë dhe teknikë në park, sipas kriterëve dhe procedurave të miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

- Formalitetet dhe procedurat doganore për hyrjen dhe daljen e mallrave në/nga parku bëhen sipas Kodit Doganor dhe ligjërimin e dokumentacionit të shtetasve të huaj që ushtrojnë veprimtari në park.

Këto përfitime fiskale do të bëhen të aplikueshme sapo parku të bëhet funksional dhe të fillojnë aktivitetet brenda tij.

4. Kompanitë dhe Përdoruesit që Synon Durana Tech Park

Durana Tech Park synon të tërheqë një grup të gjerë përdoruesish, duke përfshirë:

- Kompani Ndërkombëtare të Teknologjisë: Kompani të mëdha që operojnë në sektorë si inteligjenca artificiale (AI), robotika, cloud computing, big data, dhe zhvillimi i softuerit, të cilat kërkojnë një mjedis tërheqës dhe me kosto të ulët për të zgjeruar operacionet e tyre në Europën Juglindore.
- Kompani Kombëtare që Inovojnë: Përveç kompanive ndërkombëtare, Durana Tech Park është i fokusuar në tërheqjen dhe mbështetjen e kompanive kombëtare shqiptare që janë aktive në sektorin e teknologjisë dhe inovacionit. Kompani që operojnë në fusha si telekomunikacioni, fintech, dhe zhvillimi dixhital, do të kenë mundësi të zhvillohen më tej në një mjedis që mbështet inovacionin dhe bashkëpunimin ndërmjet industrisë dhe akademisë.
- Startup-e Teknologjike: Parku do të ofrojë programe inkubacioni dhe akselerimi për startup-et që janë në fazat e para të zhvillimit, duke i mbështetur ato me mentorim, qasje në financime dhe infrastrukturë teknologjike moderne.
- Universitete dhe Qendra Kërkimore: Një nga komponentët kyç të parkut do të jetë bashkëpunimi me institucione akademike dhe qendra kërkimore për të krijuar mundësi për kërkime të avancuara dhe për transferimin e teknologjisë nga kampuset universitare në sektorin privat.

5. Kriteret për Përdoruesit / Kompanite që do operojnë në park

- Të kenë lidhur kontratë qiraje me zhvilluesin për fillimin e aktivitetit në park, ku janë pasqyruar lehtësirat fiskale.
- Të jenë regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit për kryerjen e aktivitetit, si përdorues i parkut teknologjik dhe shkencor.
- Të kenë realizuar detyrimet që lindin nga kontrata e lidhur me zhvilluesin.
- Të përmbushin kërkesat e dokumentacionit si ekstrakti i regjistrit tregtar, vetëdeklarimet për detyrimet tatimore dhe sigurimet shoqërore, dhe mospasjen e procedurave gjyqësore lidhur me aktivitetin (Vendim Nr. 418, 2023).
- Të paraqesin dokumente të notifikuara për subjektet jashtë Shqipërisë, në zbatim të legjislacionit për ligjërimin e dokumentacionit të shtetasve të huaj që ushtrojnë veprimtari në Republikën e Shqipërisë (Vendim Nr. 418, 2023).

Kufizimet:

- Nuk lejohet transferimi i veprimtarive ekzistuese në territorin shqiptar brenda parkut për të përfituar nga lehtësitë e ligjit; vetëm veprimtaritë e reja janë të lejuara të zhvillohen në park, për të nxitur inovacionin dhe zhvillimin e teknologjive të reja.
- Subjektet nuk do të pranohen si përdorues nëse më shumë se 25% e kapitalit të autorizuar, direkt ose indirekt, i përket organeve të qeverisjes qendrore ose vendore.

6. Aktivitetet e lejuara në Durana Tech Park

Aktivitetet e lejuara në Durana Tech Park, sipas vendimit Nr. 185, datë 27.3.2024, përfshijnë një gamë të gjerë veprimtarish në fushën e teknologjisë së informacionit dhe inovacionit. Disa nga aktivitetet e lejuara:

- Dizajnim i softuerit: Përfshin analizën e kërkesave të sistemeve softuerike, projektimin e arkitekturës, dhe dizajnimin e detajuar të këtyre sistemeve.
- Zhvillimi dhe mirëmbajtja e sistemeve softuerike: Kodimi, instalimi, integrimi i komponentëve, dokumentacioni, identifikimi dhe korrigjimi i gabimeve, modifikimet, dhe mirëmbajtja e sistemeve.
- Testimi i softuerit: Përfshin testimin e funksionalitetit, ngarkesës së punës, performancës, problemeve të kodit, disponueshmërisë dhe sigurisë së sistemit softuerik.
- Projektimi dhe zhvillimi i sistemeve të komunikimit: Përfshin analizën, planifikimin, projektimin, zbatimin, vënien në punë dhe mirëmbajtjen e sistemeve të komunikimit të rrjetit të pajisjeve të teknologjisë së informacionit (LAN/WAN/WLAN/MAN/SAN/CAN).
- Projektimi dhe zhvillimi i sistemeve të sigurisë: Përfshin analizën e kërkesave të sigurisë së klientit, projektimi i arkitekturës, instalimi dhe konfigurimi i komponentëve, zbatimi, testimi dhe mirëmbajtja e sigurisë së sistemeve dhe produkteve.
- Zhvillimi i sistemeve të migracionit: Transferimi i të dhënave dhe infrastrukturës përkatëse nga një teknologji e vjetër në një të re dhe përmirësimi i sistemeve të teknologjisë së informacionit.
- Analiza e sistemeve me sasi të madhe të dhënash (Big Data): Përpunimi dhe analiza e sasive të mëdha të të dhënave për të ndërtuar modele që mund të shfrytëzohen për aktivitete biznesore të ndryshme duke përdorur inteligjencën artificiale.
- Konsulencë për inovacion dhe sigurinë e informacionit: Përfshin konsulencë për përdorimin e teknologjisë së informacionit për qëllime të inovacionit të proceseve të biznesit dhe mbrojtjen teknike dhe kriptografike të informacionit.
- Kërkime në fushën e komunikimit dhe zhvillimit të programeve inovative: Kërkimi dhe zhvillimi përfshijnë aktivitete krijuese dhe sistematike të ndërmarra për të rritur grupin e njohurive dhe për të krijuar aplikime të reja të njohurive të disponueshme.
- Aktivitete në fushën Cloud Computing: Kërkime në Cloud Computing dhe vlerësimin e rrezikut të migrimit të shërbimeve on-premises drejt shërbimeve Cloud.

Këto aktivitete janë përcaktuar për të nxitur inovacionin dhe zhvillimin në industrinë e teknologjisë së lartë në park.

7. Benefitet për Çdo Aktor

- **Për Kompanitë Ndërkombëtare:** Qasje në tregjet rajonale dhe europiane, kosto të ulëta operative dhe stimuj fiskalë që rrisin fitimet.
- **Për Kompanitë Kombëtare:** Mundësi për të zhvilluar operacione inovative në fushën e teknologjisë, duke perfituar nga lehtësirat fiskale, si përjashtimet nga tatimet dhe taksat për aktivitetet e reja, qasja në infrastrukturë moderne, dhe mundësia për të bashkëpunuar me universitetet dhe qendrat kërkimore për të nxitur kërkime dhe zhvillime të avancuara.
- **Për Startup-et:** Akselerim dhe inkubim, mbështetje financiare dhe mentorim për zhvillimin e produkteve dhe shërbimeve inovative.
- **Për Universitetet dhe Qendrat Kërkimore:** Mundësi për kërkime të avancuara në bashkëpunim me industrinë, qasje në teknologjitë më të fundit dhe mbështetje për komercializimin e ideve inovative.
- **Për Nomadët Dixhitalë:** Infrastrukturë moderne, hapësira fleksibël dhe qasje në një rrjet të gjërë profesionistësh të teknologjisë.

8. Benefitet për Ekosistemin Dixhital dhe të Inovacionit në Shqipëri

- **Rritja e Konkurrueshmërisë:** Durana Tech Park do të ndihmojë Shqipërinë të rritë konkurrueshmërinë e saj në sektorët e teknologjisë dhe inovacionit, duke tërhequr investime të huaja dhe duke zhvilluar talentin vendas.
- **Ndërtimi i Infrastrukturës Teknologjike:** Krijimi i qendrave të të dhënave (data centers), laboratorëve kërkimorë dhe hapësirave të tjera të specializuara për R&D do të rrisë kapacitetet teknologjike të vendit.
- **Nxitja e Bashkëpunimit Ndërkombëtar:** Duke krijuar një platformë bashkëpunimi ndërmjet industrisë, akademisë dhe qendrave kërkimore, parku do të lehtësojë integrimin e Shqipërisë në ekosistemet globale të inovacionit dhe teknologjisë.